



SBASHK Arsimimi sot

Në ntor, 2024

Gazeta elektronike

Krërët e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Botës dhe Evropës kundërshtojnë veprimet e Qeverisë, mbështesin SBASHK-un



Gjatë muajit nëntor 2024, SBASHK realizoi disa vizita pune në vende të ndryshme të rajonit, ku, në kuadër të Konferencës Zgjedhore të Unionit të Sindikatave të Evropës, SBASHK u përfaqësua nga Nënkrjetarja, Vjollca Shala, dhe Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, në Mal të Zi...(faqe 4)

SBASHK fillon takimet me kryetarët e partive dhe shefat e grupeve parlamentare, pritët nga PDK




Të nderuar anëtarë të SBASHK-ut duke respektuar zërin tuaj ne ishim angazhuar që me shkresa e dialog të kërkojmë nga qeveria që vlera e koeficientit të pagave të shtohet për së paku 30 %, por ...(faqe 8)

Në muajin nëntor, SBASHK organizoi mbi 25 grupe trajnimi për mësimdhënës



Në muajin nëntor, SBASHK vazhdoi me një sërë organizimesh të trajnimeve për mësimdhënësit anëtarë të Sindikatës ...(faqe 6)

SBASHK vendos për veprime sindikale, organizon protestë më 4 dhjetor



Pas takimit të Këshillit Drejtues të SBASHK-ut, në të cilin është analizuar situata aktuale dhe janë thënë kritika të ashpra e të arsyeshme ndaj Qeverisë...(faqe 8)

SBASHK viziton grevistët e Teatrit Kombëtar të Kosovës



Nënkrjetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala, sekretari i përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor, Blendor Shatri, kanë vizituar Këshillin Grevist të Shoqatës...(faqe 9)



Editorial

Nëntori i datave të mëdha të kombit tonë



Në Shqipëri, Kosovë e kudo ku jetojnë shqiptarët, sheshet u kthyen në vendtubime dhe me veshje e flamuj kombëtar, u festua duke shpalosur kujtime për momente të ndritura të historisë sonë, e duke bërë thirrje për mirëkuptim e unitet mes gjithë pjesëtarëve të kombit tonë, kudo që janë.

Atmosferë feste ishte edhe në institucionet arsimore. Aty, përmes aktiviteteve të shumta kulturore, punëtorët arsimorë, bashkë me nxënësit, shprehen krenarinë për Ditën e Flamurit dhe respektin e përjetshëm për luftëtarët dhe emrat emblemë të historisë sonë. Ata, me krenari, rikthyen kujtesën për angazhimet e vazhdueshme të bijve e bijave të kombit, që me veprat e tyre sublime, ishin në ballë të përpjekjeve për pavarësi e liri.

Mijëra qytetarë vizituan Vlorën e Flamurit edhe

Prekazin e historisë për të dëshmuar respektin e krenarinë atdhetarët, pishtarët e dijes, dhe për komandantin legjendar Adem Jashari dhe për gjithë luftëtarët e lirisë, që, me emblemën e UÇK-së, e nëpër beteja trimërie, larguan errësirën dhe sollën rrezet e lirisë për Kosovën, e cila ishte larë me gjak nëpër vite e dekada.

Sa herë vjen nëntori dhe festa e madhe e Flamurit Kombëtar, është moment i mirë që ata që janë zgjedhur për të udhëhequr me institucionet të ulen dhe të mendojnë shtruar. A kanë arsyetuar besimin e popullit dhe sa janë marrë me hallet, sfidat dhe kërkesat e qytetarëve? Ta duash atdheun do të thotë të punosh pa u ndalur në shërbim të tij dhe të qytetarëve, dhe ta kuptosh se sa do që je angazhuar, është pak.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Bisedë me Sekretarin e Përgjithshëm të SBASHK-ut, Ymer Ymeri Ndjehem i nderuar me besimin e Këshillit Drejtues



Duke parë se, në vazhdimësi Ymer Ymeri, krahas detyrave të shumta që i kërkon vendi i tij i punës, ka dhënë shumë ide dhe ka qenë në krye të shumë angazhimeve në shërbim të anëtarësisë. Këto detyra i kryente me pozitën vullnetare prej koordinatorit për organizim të brendshëm. Duke parë gjithë këtë përkushtim dhe duke u gjendur SBASHK-u në situata sfiduese e që kërkojnë shumë angazhime e përkushtim, Kryetari, Rrahman Jasharaj, duke respektuar statutin e SBASHK-ut i propozoi Këshillit Drejtues që Ymer Ymeri të zgjidhet sekretar i përgjithshëm. Anëtarët e Këshillit të Përgjithshëm, njëzëri e përkrahën propozimin e Kryetarit Jasharaj, duke kujtuar shumë angazhime të Ymerit, në shërbim të realizimit në përpikëri të aktiviteteve të shumta sindikale. Ata e përgëzuan Ymerin, sidomos për faktin që ai do ta kryej këtë detyrë, do të kryej në mënyrë vullnetare, pra pa marrë kompensim shtesë për këtë pozitë.

Në këtë numër të gazetës sonë po sjellim fragmente nga një bisedë që zhvilluam me sekretarin e përgjithshëm të SBASHK-ut.

Ymeri na tregon se ndjehet i nderuar me besimin që i është dhënë, duke shtuar se Statuti i ka caktuar një numër mjaft të madh detyrash konkrete sekretarit të përgjithshëm, por ai është i përgatitur për këto sfida, ngase një numër të madhe të këtyre detyrave i ka kryer edhe në cilësinë e koordinatorit për organizim të brendshëm.

Sekretari i përgjithshëm ndalet edhe te organizimi i trajnimeve, i cili kërkon angazhim dhe vëmendje, sepse ka raste kur vijnë shumë kërkesa të anëtarësisë për trajnime dhe sfidë, ka raste, kur është numri i duhur i trajnerëve dhe rastet kur ata janë të angazhuar edhe në aktivitete tjera arsimore, apo në obligime familjare.

Ymeri, në kuadër të kësaj bisede, ndalet edhe te protesta e 4 dhjetorit, duke treguar se, pas gjithë angazhimeve me muaj të tërë nga SBASHK-u, për të pasur dialog e për të gjetur zgjidhje të pranueshme për kërkesat legjitime të anëtarësisë, si dhe për të negociuar e nënshkruar Kontratën e re Kolektive, Qeveria, në tërësi dhe po ashtu Ministria Nagavci, vazhdojnë të jenë kundër dialogut dhe kundër sindikatave. Prandaj ka ardhur deri te vendimi i Këshillit Drejtues që të mbahet protestë më 4 dhjetor, me pjesëmarrjen e kryetarëve e kryesive të shoqatave sindikale, dhe të udhëheqësve sindikal të nivelit komunal, të universiteteve dhe të nivelit qendror. Urojmë të reflektojë Ministria Nagavci, se në të kundërtën, Këshilli Drejtues do të vendos për veprime të tjera sindikale, duke mos përjashtuar as grevën e përgjithshme.

Gjatë muajit

SBASHK për Ditën e Madhe të Flamurit Kombëtar

Të nderuara kolege, të nderuar kolegë, pishtarë të dijes dhe luftëtarë të dritës kundër errësirës, urime dita e madhe e Flamurit Kombëtar. Punëtorët e arsimit e meritojnë të festojnë, sepse nëpër vite e dekada vazhduan rrugëtimin drejt lirisë, e liria erdhi falë përkushtimit sublim të njerëzve të dijes e penës, si dhe betejave heroike të UÇK-së.

Gjithmonë paçi festa e gëzime.

Bashkë e në SBASHK, armiq të le të pëlcasin.



Krerët e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Botës dhe Evropës kundërshtojnë veprimet e Qeverisë, mbështesin SBASHK-un



Gjatë muajit nëntor 2024, SBASHK realizoi disa vizita pune në vende të ndryshme të rajonit, ku, në kuadër të Konferencës Zgjedhore të Unionit të Sindikatave të Evropës, SBASHK u përfaqësua nga Nënkrjetarja, Vjollca Shala, dhe Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, në Mal të Zi. Gjatë kësaj konference, përfaqësuesit e SBASHK-ut takuan Kryetarin e Internacionales Botërore të Arsimit, Mugwena Maluleke, dhe Sekretarin e Përgjithshëm, David Edwards dhe Drejtorin e Përgjithshëm të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Jelmer Evens.



Nënkrjetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, u kishin shpjeguar udhëheqësve më të lartë sindikalë të Evropës dhe botës se kryetari i SBASHK-ut nuk merr pjesë në Konferencën Vjetore të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës pikërisht për shkak të gjendjes së rëndë të krijuar në arsim dhe sektorët tjerë, me fajin e Qeverisë Kurti, e cila vazhdon të ketë qasje të gabuar ndaj dialogut dhe një qasje deri në armiqësore ndaj SBASHK-ut dhe sindikatave të tjera. Përfaqësuesit e SBASHK-ut pastaj u kanë ofruar shumë argumente

Kryetarit të Internacionales Botërore të Arsimit, Mugwena Maluleke Sekretarit të Përgjithshëm, David Edwards, dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës Jelmer Evens.



Duke theksuar se Qeveria Kurti, dhe vet Ministria e Arsimit, znj. Nagavci, në vazhdimësi janë angazhuar ta pamundësojnë dialogun sindikal me sindikatat duke bllokuar punën e Këshillit Ekonomik Social, duke vështirësuar funksionimin dhe veprimtaritë sindikale dhe duke qenë kategorik kundër nënshkrimit të Marrëveshjes Kolektive në nivel vendi dhe të Kontratës së re Kolektive të Arsimit.



Ata janë shprehur se sindikatat po kalojnë nëpër sfida tepër të vështira dhe shumë nga to, fatkeqësisht edhe janë afër shuarjes, por SBASHK-u falë unitetit dhe besimit të anëtarësisë dhe angazhimeve e përkushtimit të madh të udhëheqjes sindikale vazhdon të jetë e fortë dhe do të vazhdojë me betejat në përpjekjet për realizimin e kërkesave legjitime të anëtarësisë duke nisur edhe me veprime sindikale, siç është protesta e 4 dhjetorit, dhe veprimet tjera që do të ndodhin nëse Ministria e Arsimit dhe Qeveria nuk reflektojnë.



Kryetari i Internacionales Botërore të Arsimit, Mugwena Maluleke, Sekretari i Përgjithshëm, David Edwards dhe Drejtori i Përgjithshëm të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, Jelmer Evens, janë shprehur tepër

të shqetësuar me këtë realitet dhe kanë ripërsëritur se Internacionalja Botërore e Arsimit, që numëron 32 milionë anëtarë dhe Unioni i Sindikatave të Evropës, që numëron 11 milionë anëtarë, mbështesin fuqishëm SBASHK-un në gjithë angazhimet. Ata kanë ngritur shumë kritika ndaj Qeverisë së Kosovës. Sekretari i përgjithshëm, i Internacionales Botërore të Arsimit u ka deklaruar përfaqësuesve të SBASHK-it se, gjithë këto shqetësime dhe reagimin e fuqishëm ndaj Qeverisë Kurti, për qasjen e gabuar ndaj dialogut dhe SBASHK-it, do të prezantojë me t'u kthyer në SHBA, dh e po ashtu do ta prezantojë këtë situatë tepër të rënduar edhe në UNESKO.



Në këtë konferencë speciale të ETUCE-s, u bë edhe zgjedhja e udhëheqësisë së re të Komitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës (ETUCE) ku në vend të presidentit të ETUCE-s, Lary Flanagan, u zgjodh presidenti i ri John MacGabhann.

Si parapërgatitje për këtë vizitë, SBASHK mori pjesë edhe në një aktivitet online, të veçantë të sindikatave të Evropës, ku Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës zhvilloi një varg aktivitete para Konferencës Vjetore të këtij Unioni, të mbajtur më 26 e 27 nëntor në Budva të Malit të Zi, me temën kyçe të debatit: “Lufta për të Ardhmen e Arsimit Publik në një Evropë Sociale”.



Gjatë muajit nëntor, SBASHK mori pjesë edhe në Konferencën Ndërkombëtare për Demokracinë, të organizuar në Shqipëri, ku, para fillimit të Kongresit të 7-të të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, u mbajt Konferenca Ndërkombëtare për Demokracinë.



Në këtë Konferencë, pjesëmarrës ishin Kryetari i SBASHK -ut, Rahman Jasharaj, Koordinator i Organizimit të Brendshëm, Ymer Ymeri, dhe Zyrtari Ligjor, Blendor Shatri. Mikpritësit, Kolë Nikollaj dhe Anisa Subashi bashkë me përfaqësues të sindikatave pjesëmarrëse, diskutuan për sindikatat, dialogun social dhe qasjet e gabuara të qeverive ndaj sindikatave. Pjesëmarrësit e këtij aktiviteti vlerësuan se, kriter, se

sa ka demokraci, ka në një shtet, është qasja e qeverisë ndaj dialogut dhe sindikatave, sepse kudo ka tendenca për luftë kundër sindikatave, demokracia zbehet dhe cenohet. Në Kongresin e 7-të të Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, SBASHK-u ishte pjesëmarrës krah sindikatave tjera nga vende të ndryshme të Ballkanit dhe Evropës. Kurse, gjatë konferencës në Tiranë, u vlerësua se nuk ka demokraci pa sindikata. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë para mbajtjes së Kongresit të 7-të, ka organizuar Konferencën ndërkombëtare me temën kyçe, “Sindikatat për Demokraci”. Udhëheqës sindikalistë nga vende të ndryshme të Ballkanit dhe të Evropës kanë alarmuar se sindikatat po kalojnë në momente të vështira e plot sfida, ngase mungon dialogu i duhur social dhe vullneti i qeverive për të zgjidhur kërkesat legjitime të punëtorëve në të dy sektorët.



Diskutuesit në këtë Konferencë kanë theksuar se kriter matës se sa vërtetë ka demokraci në një shtet është edhe ai se cila është qasja e qeverive ndaj dialogut dhe ndaj sindikatave. Kjo nënkupton se aty ku ka qasje të gabuar dhe refuzuese ndaj sindikatave, aty ka qasje refuzuese edhe ndaj frymës demokratike, apo ka sulm ndaj demokracisë sepse një shoqëri pa dialog e pa sindikata, është një shoqëri jodemokratike sa kërkohet e duhet. Bazuar në diskutimet dhe argumentimet e dhëna në këtë Konferencë ndërkombëtare dhe duke e parë situatën në Kosovë lidhur me dialogun dhe qëndrimin e Qeverisë ndaj sindikatave, del se demokracia i ka punët keq, sepse Qeveria në këto katër vite kishte vazhdimisht qasje të gabuar ndaj dialogut dhe sindikatave, e madje në momente sikur u ka shpallur edhe luftë me qëllim që të zhbëjë aktivitetin e tyre, apo edhe t'i shuaj në tërësi. Qeveria Kurti, duhet ta dijë se duke tentuar t'i dobësojë dhe shuajë sindikatat, ajo ka goditur lirinë e organizimit sindikal dhe vetë demokracinë.



Në muajin nëntor, SBASHK organizoi mbi 25 grupe trajnimi për mësimdhënës.




Në muajin nëntor, SBASHK vazhdoi me një sërë organizimesh të trajnimeve për mësimdhënësit anëtarë të Sindikatës, nëpër komuna të ndryshme të Kosovës.



Në Suharekë, gjatë muajit nëntor, kanë filluar tri grupe të reja të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK: Bahrije Elshani, Emin Hoxha dhe Korab Blakaj. Trajnimet i kishte përcjellur nga afër edhe kryetari i SKAP-it,



Nazim Gashi, derisa grupet e mësimdhënësve vazhdonin trajnimet e organizuara gjatë ditëve të vikendit për shtatë ditë me radhë, sa zgjat trajnimi.



Në muajin nëntor, me 4 grupe të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie” ka filluar edhe Prizreni, me trajnerët e përcaktuar nga SBASHK-u:

Naser Kastratin, Albert Samadraxha, Emin Hoxha dhe Arben Zymberi. Mësimdhënësit gjatë trajnimit i vizitoi edhe nënkryetarja e SKAP në këtë komunë, znj. Hyrije Hoti. Gjatë nëntorit në Prizren, nga nënkryetarja e SBASHK-ut, znj. Vjollca Shala, ishte organizuar edhe testi për dy grupe të mësimdhënësve, të cilët i kishin përfunduar trajnimet e filluara javë më pare. Po në këtë komunë, gjatë muajit nëntor, janë mbajtur edhe dy grupe të trajnimit në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social”, trajnimin, me trajnerë, Skender Gashi dhe Kastriot Veselaj.

Me tri grupe të trajnimit gjatë muajit nëntor, ka filluar edhe Mitrovica në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, ku dy grupe janë mbajtur në modulin e parë të trajnimit me trajner Kadri Hyseni





dhe Afrim Haziri dhe një grup me modulin e dytë të këtij trajnimi, me trajner Fevzi Selmani. Nërkohë, gjatë këtij muaji në Mitorvicë është organizuar nga Sekretari

i përgjithshëm i SBASHK-ut, z. Ymer Ymeri dhe zyrtarja znj. Nezafate Jakupi edhe testi për një grup të mësimeve, të cilët e kanë përfunduar këtë trajnim.



Me programin e njëjtë të trajnimit, me një grup gjatë muajit nëntor, filloi edhe Dragashi me trajner, Admir Halimi, kurse për mbarëvajtjen e trajnimit është kujdesur edhe kryetari i SKAP-it për Dragash, Vloran Krasniqi.



Vushtrria, po ashtu, e ka mbajtur një grup të trajnimit në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” me trajner, Nexhmedin Gruda.

Nërkohë, mësimeve dhe mbarëvajtjen e procesit të trajnimit e ka përcjellë nga afër edhe kryetari i SKAP-it, Kadri Hyseni.

Gjatë muajit nëntor, në Ferizaj janë mbajtur gjashtë grupe të trajnimit. Në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime”, në këtë komunë janë mbajtur 2 grupe të trajnimit me trajnerët e përzgjedhur nga SBASHK: Musli


Neziri, Naser Guri. Kurse, në programin “Forcimi i kapaciteteve për udhëheqjen efektive të dialogut social” ishin mbajtur dy grupe të mësimeve me trajnerë Safet Beqiri dhe Emrush Ahmeti.



Gjatë muajit nëntor, në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” janë organizuar edhe dy grupe të trajnimit në Lipjan, me trajnerë Berona Ahmeti dhe Idriz Sopa, kurse janë organizuar testet për dy grupe tjera të cilat e kanë përfunduar trajnimin në këtë program të filluar më parë.




Me trajner, Burim Krasniqi, dy grupe të trajnimit kanë filluar edhe në Pejë, derisa për tu kujdesur për mbarëvajtjen e tij dhe organizimin e trajnimit, në Pejë, kishte qëndruar edhe vet kryetari i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, i cili i kishte njoftuar të pranishmit lidhur me aktivitetet sindikale dhe vendimet e nxjerra nga mbledhja e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut, të mbajtur ditë më parë.



Gjatë muajit nëntor, në programin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësime” janë organizuar edhe nga një grup i trajnimit në Shtime.

SBASHK vendos për veprime sindikale, organizon protestë më 4 dhjetor




Pas takimit të Këshillit Drejtues të SBASHK-ut, në të cilin është analizuar situata aktuale dhe janë thënë kritika të ashpra e të arsyeshme ndaj Qeverisë dhe, veçmas ndaj Ministrisë së Arsimit për mungesë të dialogut dhe për shkak të qasjes të gabuar ndaj kërkesave legjitime të anëtarësisë së SBASHK-ut, dhe veçmas ndaj bllokimit me qëllim të ministres Nagavci, të negocimit për Kontratën e re Kolektive të Arsimit, në orët e mbrëmjes së të dielës është mbajtur takimi konsultativ me kryetarët e nivelit komunal sindikal e të universiteteve dhe të gjithë kanë ripërsëritur vendimin e Këshillit Drejtues për të filluar me veprime sindikale.

U vendos që veprimi i parë sindikal të jetë protesta më 4 dhjetor, me pjesëmarrjen e kryetarëve dhe kryesive nga të gjitha shoqatat sindikale, që nga çerdhet e deri në universitete, të anëtarëve të Këshillit Drejtues, të kryetarëve e kryesive të nivelit komunal sindikal e të universiteteve, si dhe të kryesisë qendrore, duke parashikuar rreth 2000 protestues.

Kjo protestë do të nisë para Ministrisë së Arsimit e

pastaj do të marshohet drejt Qeverisë dhe Parlamentit të Kosovës. Ky do të jetë veprim i parë sindikal pas protestës së 1 Majit të këtij viti dhe përpjekjeve të vazhdueshme për dialog, dhe do të vazhdohet edhe me veprime të tjera sindikale, duke mos përjashtuar edhe grevën në tërë sektorin e arsimit, nëse Qeveria dhe, në veçanti Ministria e Arsimit nuk reflekton dhe nuk nisë negocimin për Kontratën e re Kolektive të Arsimit, e cila është bazë që siguron respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve të arsimit. Nuk ka shtet në botë që pretendon të jetë demokratik e që nuk ka të nënshkruar Marrëveshjen Kolektive në nivel vendi dhe të Kontratave kolektive të sektorëve, por në Kosovë kjo po ndodh. Prandaj duke respektuar vullnetin e anëtarësisë, jemi të detyruar të nisim me veprime sindikale. SBASHK-u, për gjithë angazhimet dhe përkushtimin ndaj kërkesave të anëtarësisë, gëzon mbështetjen e fuqishme të Unionit të Sindikatave të Evropës, që numëron 11 milionë anëtarë, dhe të Internacionales Botërore të Arsimit, që numëron 32 milionë anëtarë nga e tërë bota.



SBASHK fillon takimet me kryetarët e partive dhe shefat e grupeve parlamentare, pritet nga PDK



Nisma qytetare për ndryshim-plotësimet në Ligjin për skemat pensionale, e mbështetur nga 20,606 nënshkrime, ka kaluar disa nga procedurat e parapara dhe pritet të rikthehet në Kuvendin e Kosovës, për procedura të mëtejshme deri në votimin nga deputetët.

Për të përshpejtuar këto procedura dhe për të kërkuar mbështetjen e subjekteve politike, SBASHK-u iu dergoi ftesa për takime kryetarëve të VV-së, PDK-së, LDK-së dhe AAK-së. Takimet kanë nisur me pjesëmarrjen e Kryetarit të PDK-së, Memli Krasniqi, dhe shefit të Grupit Parlamentar të kësaj partie, Abelard Tahiri.

Ata u takuan me kryetarin e SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, sekretarin e përgjithshëm, Ymer Ymeri, dhe zyrtarin ligjor, Blendor Shatri. Përfaqësuesit e SBASHK-ut, kanë falënderuar përfaqësuesit e PDK-së, për përgjigjen e tyre positive, dhe prezantuan procedurat që ka kaluar nisma qytetare për ndryshimin e Ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti. Ata theksuan se, qëllimi është rikthimi i të drejtës që vitet e 90-ta, të konsiderohen vite kontributdhënëse, duke përfshirë

edhe vitet deri në fillimin e funksionimit të Trustit Pensional. Përfaqësuesit e SBASHK-ut, u shprehën se situata aktuale është e papranueshme, pasi favorizohen ata që kanë qenë lojal ndaj pushtuesit serb, ndërsa ndëshkohen ata që kanë punuar dhe kontribuar për lirinë dhe shtetësinë e Kosovës.

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, dhe shefi i Grupit Parlamentar, Abelard Tahiri, shprehën mbështetjen e

tyre për këtë nismë qytetare, duke premtuar angazhim maksimal në Kuvend, duke e cilësuar këtë çështje si një hap të rëndësishëm për njohjen e kontributit të viteve të 90-ta, një periudhë e lavdishme për popullin dhe shtetësinë e Kosovës. SBASHK, shpreson që gjatë ditëve të ardhshme të zhvillojë takime edhe me kryetarët dhe shefat e grupeve parlamentare të VV-së, LDK-së dhe AAK-së.

SBASHK viziton grevistët e Teatrit Kombëtar të Kosovës



Nënkryetaria e SBASHK-ut, Vjollca Shala, sekretari i përgjithshëm, Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor, Blendor Shatri, kanë vizituar Këshillin Grevist të Shoqatës Sindikale të Teatrit Kombëtar, ku për së afërmi janë njoftuar me kërkesat e grevistëve, të cilëve iu shprehën

shqetësim për mostakime me ministrin e Kulturës, Hajrullah Çeku, për realizimin e kërkesave të tyre. Aq më tepër kur kihet parasysh se Teatri Kombëtar është teatër në nivel shteti, kërkesat e tyre janë kërkesa minimale në buxhet, që kostoja mujore është rreth 4 mijë e 600 euro, e ka të bëjë me 22 artistë. Përfaqësuesit e SBASHK-ut i shprehën mbështetjen Këshillit Grevist dhe u zotuan se do t'i drejtohen me kërkesë ministrit të Kulturës, Hajrullah Çekut, që të ulet me Këshillin Grevist dhe të gjejë formën dhe mundësinë për realizimin e kërkesave të tyre në mënyrë që artistët t'i kthehen obligimeve ditore që kanë në punë si artistë.



Takim vëllazëror në SBASHK



Në pasditen e 7 nëntorit, selinë e SBASHK-ut e vizituan Kryetari i Kuvendit Komunal të Bujanocit, z. Driton Rexhepi, Kryeshefi i Shërbimeve Publike, z. Kastriot Jakupi dhe Këshilltari për Arsim i kësaj komune, z. Agim Hasani. Ata u pritën nga Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, Koordinator i Organizimit të Brendshëm, z. Ymer Ymeri dhe anëtarë të tjerë të stafit. Pjesë e këtij takimi ishte edhe veprimtari, z. Fehmi Berisha, i cili i gëzohet çdo suksesi të SBASHK-ut. Ky takim vëllazëror, në të cilin Kryetari, Jasharaj,

është shprehur se ndjehet i nderuar me këtë vizitë të vëllazërve nga Bujanoci, e pastaj u tregoi për angazhimet e SBASHK-ut në shërbim të anëtarësisë, për sfidat dhe për arritjet e shumta. Koordinator i Organizimit të Brendshëm, z. Ymer Ymeri në fjalën e mirëseardhjes, njoftoi mysafirët për angazhimet aktuale për t'u ndalur edhe te trajnimet. Ai shprehu gatishmëri për bashkëpunim në sferën e arsimit me kolegët nga Bujanoci, Presheva e Medvegja. Kryetari i Kuvendit Komunal të Bujanocit, z. Driton Rexhepi, falënderoi përfaqësuesit e SBASHK-ut për pritjen vëllazërore dhe vlerësoi lart angazhimin e sindikatës sonë në shërbim të anëtarësisë duke përmendur edhe shumë nga arritjet e SBASHK-ut.

